

SHËRBIME KUJDESTARIE DHE INVESTIMI

SHËRBIMI I KUJDESTARISË



Është shërbimi që ofrojnë bankat për të investuar fondet e tua në letra me vlerë të qeverisë.

Nëse investon në letra me vlerë nëpërmjet bankës, ajo kujdeset për pagesën e kuponit, pagesën e kryegjësë në datën e maturimit, informon mbi normat e interesit etj.

Letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare janë instrumente të tregtueshme borxhi, të emetuara dhe garantuara nga qeveria. Pra, këto alternativa investimi kanë rrezik të ulët. Në varësi të afatit të maturimit, ato ndahen në:

BONO THESARI



Janë instrumente financiare afatshkurtra, me maturim 3, 6 dhe 12-mujor. Interesi i përfituar prej tyre llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës nominale dhe çmimit të blerjes së kuponit.

OBLIGACIONE




Janë instrumente financiare afatmesme dhe afatgjata me maturitet 2, 3, 5, 7, 10 dhe 15-vjeçar. Interesi i përfituar në formën e kuponit, paguhet çdo 6 muaj gjatë kohëzgjatjes së instrumentit. Përgjithësisht, obligacionet emetohen me kupon fikse, pra një normë fikse interesi gjatë gjithë kohëzgjatjes së obligacionit, por mund të emetohen edhe me kupon variabël.

FONDE INVESTIMI

Një fond investimi është një sipërmarrje kolektive që bën bashkë kapitalin e një numri të madh investitorësh (individë që dëshirojnë të investojnë kursimet e tyre), për të investuar në asete të caktuara me kthim të lartë, bazuar në një strategji paraprake.

ÇFARË OFROJNË BANKAT?



ÇFARË OFROJNË BANKAT?

Bankat u ofrojnë klientëve të tyre:

- produkte pagesash (llogari rrjedhëse),
- produkte kursimi (depozita),
- produkte financimi në formën e kredive, dhe
- shërbime kujdestarie apo investimi.

#EdukimFinanciar

#EdukimFinanciar



PRODUKTE PAGESASH

LLOGARIA RRJEDHËSE



Është llogaria e parë që lidh klientin me bankën. Si llogari pagese, ajo bën të mundur të gjitha transaksionet bankare, si: derdhje, tërheqje, transferta, pagesa utilitare, pagesa kredie, veprime me karta. Përgjithësisht, llogaria rrjedhëse nuk ofron interes dhe ka komisione minimale mirëmbajtjeje.

Si aksesohet?

Llogaria rrjedhëse mund të aksesohet përmes bankingut digjital (App), në sportelin e një banke ose në bankomate (ATM), përmes kartës së debitit ose kreditit.

LLOGARIA E PAGESAVE ME SHËRBIME BAZIKE



Kjo llogari i mundëson akses në shërbimet bankare bazë, pensionistëve dhe individëve të shtresave në nevojë që nuk kanë një llogari bankare. Ajo ofrohet pa komision apo me komisione minimale dhe vetëm në monedhën vendase, Lek.

Llogaria Bazike ofron një sërë shërbimesh bazë, të tilla si:

- depozitime,
- tërheqje fondesh,
- pagesa dhe transferta brenda vendit përmes sporteleve, kartave të debitit apo platformave online.

KARTA E DEBITIT



Është karta e ofruar nga banka, nëpërmjet të cilës akseson paratë/fondet në llogarinë tënde rrjedhëse. Me të mund të paguash në dyqane fizike apo online, të tërheqësh, të depozitosh apo të kontrollosh gjendjen nga ATM-të.

PRODUKTE KURSIMI

LLOGARIA E KURSIMIT



Llogaria e kursimit të lejon të ruash paratë e tua dhe të përfitosh interesa për to. Ajo është ideale nëse dëshiron të akumulosh fonde për të ardhmen, për blerje të mëdha apo për emergjencë financiare.

Ndryshe nga llogaritë e pagesave, llogaritë e kursimit ofrojnë interesa, por nuk përdoren për të kryer pagesa. Nga ana tjetër, ato ofrojnë më pak interesa se depozitat dhe fondet në to mund aksesohen në çdo kohë.

DEPOZITA



Është produkt kursimi nëpërmjet të cilit klienti mund të ruajë para në bankë për një afat të caktuar ose jo, kundrejt përfitimit të një interesi sipas kushteve të kontratës.

Gjatë afatit të maturimit të depozitës, fondet në të janë të bllokuara dhe nuk mund të tërhiqen nga klienti, pa humbur ineteresat. Sa më afatgjatë të jetë depozita, aq më të larta janë interesat që përfitohen prej saj.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave siguron çdo depozitues, pavarësisht numrit të depozitave apo llojit të tyre, në çdo bankë deri në 2.500.000 lekë dhe në çdo shoqëri kursim – krediti deri në 2.000.000 lekë.

PRODUKTE FINANCIMI

KARTA E KREDITIT



E lejon kartëmbajtësin të kryejë pagesa (blerje të mirash e shërbimesh) ose të tërheqë para, deri në një limit kredie të aprovuar nga banka. Blerjet apo pagesat mund të shlyhen muajin pasardhës ose në një periudhë më të gjatë, sipas një plani të mundësuar nga banka, kundrejt një interesi.

KREDIA KONSUMATORE



Është produkti bankar, përmes të cilit banka i jep hua klientit një shumë të caktuar parash, për financimin e nevojave vetjake, të palidhura me veprimtari tregtare ose ushtrimin e profesionit.

KREDIA KUFË APO OVERDRAFT



Është një linjë kredie ose një paradhënie bankare mbi pagën, e cila i jep mundësinë klientit të tërheqë para përtej gjendjes së tij në llogarinë rrjedhëse, deri në një kufi të caktuar dhe në mënyrë të përsëritur.

KREDIA HIPOTEKARE



Është produkti nëpërmjet të cilit banka i jep klientit një hua për të blerë, ndërtuar ose rikonstruktuar një pasuri të paluajtshme rezidenciale (shtëpi, apartament ose truall, ku do të ndërtohet një banesë). Kredia hipotekare zakonisht garantohej me objektin që po blihet/rikonstruktohet apo rinovohet, duke e vendosur si kolateral.